



PROPOZIM

Në bazë të nenit 48, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21) dhe në lidhje me pikën 8) të Vendimit për përcaktimin e mënyrës, të formës dhe të afateteve të dorëzimit të të dhënave dhe/ose informacionit nga lista e shërbimeve më përfaqësuese ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 276/22), guvernatorja e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

UDHËZIM

për mënyrën e dorëzimit të të dhënave dhe informacioneve të tarifave të shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me llogarinë pagesore

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim e rregullon mënyrën e dorëzimit të të dhënave dhe informacioneve, të cilat ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar t'i dorëzojnë te Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore) dhe që i referohen tarifave që i paguajnë konsumatorët për shërbimet më përfaqësuese që lidhen me llogari pagesore (në tekstin e mëtejme: shërbimet më përfaqësuese).

Të dhënat dhe informatat nga paragrafi (1) i këtij udhëzimi dorëzohen me qëllim të krahasimit të tarifave për shërbimet më përfaqësuese, që do të publikohen në ueb-faqen e mirëmbajtur nga Banka Popullore.

II. MËNYRA E DORËZIMIT

2. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar te Banka Popullore të dorëzojnë:

2.1. Të gjitha dokumentet e informacionit në lidhje me tarifat, në pajtim me Vendimin për përcaktimin e listës së shërbimeve më përfaqësuese në lidhje me llogarinë pagesore dhe formën dhe përmbajtjen e dokumentit informativ, në lidhje me tarifat dhe raportin e tarifave dhe simbolet e tyre të përbashkëta. ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 271/22) (në tekstin e mëtejme: dokumentet informative mbi tarifat) që ofruesi i shërbimeve pagesore ka në ofertën e tij.

2.2. Të dhënat dhe informacionet e tarifave të shërbimeve më përfaqësuese për llogari pagesore në denarë që nuk ofrohen si pjesë e paketës së ofertave.

2.3. Të dhënat dhe informacionet e tarifave të shërbimeve më përfaqësuese për llogari pagesore në valutë të ndryshme nga denari që nuk ofrohen si pjesë e paketës së ofertave.

3. Dokumente informative mbi tarifat dhe të dhënat dhe informacionet nga pika 2) e këtij udhëzimi dorëzohen për kategoritë në vijim:

A) "LLOGARI PAGESORE ME FUNKSIONE THEMELORE NË DENARË - SHFRYTËZUES TË TË DREJTAVE LIGJORE";

B) "LLOGARI PAGESORE ME FUNKSIONE THEMELORE NË DENARË" ;

C) "LLOGARI PAGESORE NË DENARË" – llogaritë pagesore në denarë që nuk mbulohen nga asnjë nga kategoritë e nënpikave A dhe B të kësaj pike, dhe

Ç) "LLOGARI PAGESORE NË VALUTË TË NDYSHME NGA DENARI".

4. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të sigurojnë se të dhënat dhe informacionet e dorëzuara në pajtim me pikën 2) të këtij vendimi, përgjigjen me të dhënat dhe informacionet e përfshira në tarifën e vlefshme, që zbatohet për shërbimet përkatëse që tarifohen nga konsumatorët dhe i përfshijnë çmimet përfundimtare, të cilat konsumatorët i paguajnë për ato shërbime, përfshirë edhe taksën mbi vlerën e shtuar për shërbimet që i nënshtrohen kësaj takse.

Të dhënat dhe informacionet e dorëzuara nga ofruesit e shërbimeve pagesore duhet të përfshijnë vetëm tarifat për shërbimet të cilat janë të vlefshme në momentin e publikimit të tyre nga Banka Popullore dhe janë të dobishme për konsumatorin, me kusht që të respektohen kushtet e ofruesit të shërbimeve pagesore dhe të jenë në pajtim me rregulloren në fuqi.

5. Ofruesit e shërbimeve pagesore i dorëzojnë të gjitha dokumentet informative me çdo ndryshim për tarifat dhe të gjitha të dhënat e dokumentit informativ mbi tarifat për llogaritë pagesore nga pika 2) e këtij udhëzimi, pavarësisht nëse ata dorëzojnë, fshijnë ose korrigjojnë të dhëna të caktuara duke zëvendësuar, kështu të gjitha të dhënat e dorëzuara më parë nga ofruesi i shërbimit pagesor dhe që në datën e përcaktuar në njoftimin që dorëzohet. Data e specifikuar në njoftim është data nga e cila Banka Popullore do të përditësojë faqen e saj të internetit për të dhënat e dorëzuara.

6. Ofruesit e shërbimeve pagesore i dorëzojnë të dhënat dhe informatat nga pika 2) e këtij vendimi në skedar në formatin XML, sipas udhëzimeve teknike për mënyrën e dorëzimit të të dhënave për publikim dhe krahasimin e tarifave dhe në pajtueshmëri me vendimin që rregullon lidhjen me sistemin e informacionit të Bankës Popullore.

Dokumentet informative mbi tarifat nga pika 2.1) e këtij udhëzimi dorëzohen në formatin PFD, sipas standardit ISO 32000 nga "të paktën specifikimi PDF 1.7", ku një dokument në PDF është një dokument informues mbi tarifat. Për çdo dokument informacioni mbi tarifat (dokument në PDF), ofruesit e shërbimeve pagesore vendosin një emër të veçantë, respektivisht, një ofrues i shërbimit pagesor nuk mund të ketë më shumë dokumente informative mbi tarifat me të njëjtin emër të dokumentit në PDF.

7. Në rastet e pamundësisë së dorëzimit të skedarëve në pajtim me pikën 6) të këtij udhëzimi, dokumentet e informacionit mbi tarifat, të dhënat dhe informacionet dorëzohen në letër ose medie tjetër jetëgjat në adresën zyrtare të Bankës Popullore.

III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

8. Ky vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

U nr. 02-1707/1
18.01.2023
Shkup

Guvernatorja
e Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска